FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 18

Tiranë – E hënë, 17 shkurt 2020

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 5/2020 datë 30.1.2020	Për dhënie amnistie	1323
Dekret i Presidentit nr. 11439, datë 14.2.2020	Për shpallje ligji	1326
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 107, datë 13.2.2020	Për lirim nga detyra	1326
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 108, datë 13.2.2020	Për emërim në detyrë	1326
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 109, datë 13.2.2020	Për emërim në detyrë	1326
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 111, datë 13.2.2020	Për emërimin në detyrë të një anëtari të Komisionit Kombëtar Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura	1326
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 112, datë 13.2.2020	Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, të truallit me sipërfaqe 620 m² dhe të ndërtesës dykatëshe, me sipërfaqe 116 m², pjesë të pasurisë 1/156, zona kadastrale 1664, Njësia Administrative Fushë-Krujë, Bashkia Krujë	1327
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 113, datë 13.2.2020	Për kalimin, në pronësi të Bashkisë Pukë, për Njësinë Administrative Pukë, të pasurisë 1/258, zona kadastrale 3069, me emërtimin "Godinë 2 kate zyra", dhe për një ndryshim në vendimin nr. 359, datë 5.6.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Shërbimit Informativ Shtetëror", të ndryshuar	1329

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 114, datë 13.2.2020	Për kalimin në pronësi nga Ministria e Mbrojtjes te Bashkia Vlorë, të një pjese të truallit funksional brenda territorit të pronës nr. 912, me emërtim "Shtëpia e ushtarakëve", me vendndodhje në Vlorë, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes", të ndryshuar.....	1331
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 115, datë 13.2.2020	Për dhënien e ndihmës së menjëhershme financiare punonjësit të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, në rast të dëmtimit të rëndë të pronës, për shkak të detyrës.....	1333
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 117, datë 13.2.2020	Për miratimin e buxhetit të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, për vitin 2020.....	1334
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 118, datë 13.2.2020	Për përcaktimin e procedurës së vlerësimit të kontributit të donacioneve në formën e pasurive të paluajtshme.....	1337
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 119, datë 13.2.2020	Për procedurat e pagesës dhe të rivlerësimit të pasurive të paluajtshme që janë në proces regjistrimi, duke përfshirë edhe pasuritë e legalizuara, në përputhje me ligjin nr. 90/2019, "Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme.....	1337
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 123, datë 13.2.2020	Për një ndryshim në vendimin nr. 594, datë 31.8.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit 'Vija bregdetare e qytetit të Vlorës, faza 1, shtesa, pjesa lindore', Vlorë".....	1344
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 124, datë 13.2.2020	Për kalimin në pronësi nga Qendra e Realizimit të Veprave të Artit te Bashkia Tiranë, të pasurisë nr. 4/239-n, me emërtimin "Qendra e Realizimit të Veprave të Artit", në zonën kadastrale 8260.....	1345
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 125, datë 13.2.2020	Për emërimin në detyrë të Drejtorit të Qendrës Kombëtare të Kulturës për Fëmijë dhe Teatrit të Kukullave.....	1350
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 127, datë 13.2.2020	Për kriteret e rregullat dhe për lejimin e veprimtarisë për mbledhjen, aksesin e përdorimin e materialeve dhe të mostrave nga mjediset e zonave të mbrojtura mjedisore.....	1350
Udhëzim i përbashkët i ministrit të Drejtësisë dhe i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 1, datë 15.1.2020	Për një ndryshim në udhëzimin e përbashkët nr. 33, datë 29.12.2014, "Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për veprime e shërbime të administratës gjyqësore të Ministrisë së Drejtësisë, Prokurorisë dhe Noterisë", të ndryshuar.....	1354
Udhëzim i përbashkët i ministrit të Drejtësisë dhe ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 2, datë 22.1.2020	Për një ndryshim në "Udhëzimin e përbashkët nr. 1276/5, datë 27.7.2017, 'Për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror'", i ndryshuar, të ministrit të Drejtësisë dhe ministrit të Financave dhe Ekonomisë.....	1355
Urdhër i ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. 18, datë 17.1.2020	Për disa shtesa dhe ndryshime në urdhrin nr. 267, datë 24.7.2019, "Mbi miratimin e rregullores për mënyrën, kriteret dhe procedurat e kategorizimit të strukturave akomoduese", i ndryshuar.....	1355
Urdhër drejtorit të Përgjithshëm të Arkivave nr. 96, datë 10.2.2020	Për delegim kompetencash.....	1356

LIGJ
Nr. 5/2020

PËR DHËNIE AMNISTIE

Në mbështetje të neneve 81, pikat 1 e 2, shkronja "ë", dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1
Qëllimi dhe parimet e ligjit

1. Qëllimi i këtij ligji është të përjashtojë nga vuajtja e dënimit, tërësisht ose pjesërisht, të gjithë personat që plotësojnë kriteret, sipas dispozitave të këtij ligji.

2. Dhënia e amnistisë, sipas këtij ligji, udhëhiqet nga parimet e:

a) humanizmit;

b) arritjes së qëllimit të dënimit;

c) rrezikshmërisë së ulët të personave që amnistohen;

ç) edukimit dhe të rehabilitimit;

d) mbrojtjes së interesit publik;

dh) dhënies së mundësisë së integrimit më të lehtë dhe më të shpejtë të të dënuarve, të mitur dhe femra.

Neni 2
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "I dënuar" konsiderohet:

a) personi i dënuar nga gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe gjykatat e shkallës së parë për krime të rënda dhe që, brenda afatit ligjor, nuk është bërë ankim në gjykatat respektive të apelit, duke marrë formë të prerë brenda datës 31.12.2019;

b) personi i dënuar deri në datën 31.12.2019 nga gjykatat respektive të apelit;

c) personi i dënuar deri në datën 31.7.2017 nga Gjykata e Lartë, kur kjo e fundit ka shqyrtuar çështjen në themel dhe ka disponuar me vendim, sipas parashikimeve të shkronjave "b", "c" dhe "d", të nenit 441, të Kodit të Procedurës Penale, dhe për personat e dënuar deri në datën 31.12.2019 nga Gjykata e Lartë, e cila ka disponuar me vendim, sipas parashikimeve të shkronjës "b", të nenit 441, të Kodit të Procedurës Penale;

ç) personi i dënuar deri në datën 31.7.2017 nga Gjykata e Lartë, kur kjo e fundit ka gjykuar si shkallë e parë.

2. "Person që i është shmangur drejtësisë" është shtetasi, i cili i është shmangur ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të dënimit deri në datën 31.12.2019.

Neni 3
Kriteret për përfitimin e amnistisë

1. Amnistohen personat meshkuj, dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, me burgim deri në 2 vjet ose çdolloj dënimi tjetër më të butë, duke përfshirë gjobën ose një nga llojet e alternativave të dënimit me burgim, për dënime të dhëna deri në datën 31.12.2019, pavarësisht nga koha e mbetur nga dënimi.

2. Amnistohen personat femra dhe të mitur, dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, me burgim deri në 3 vjet ose çdolloj dënimi tjetër më të butë, duke përfshirë gjobën ose një nga llojet e alternativave të dënimit me burgim, për dënime të dhëna deri në datën 31.12.2019, pavarësisht nga koha e mbetur nga dënimi.

3. Amnistohen personat meshkuj, dënuar me burgim, të cilëve, deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, u ka mbetur pa vuajtur nga ky dënim deri në 2 vjet.

4. Amnistohen personat femra dhe të mitur, dënuar me burgim, të cilëve, deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, u ka mbetur pa vuajtur nga ky dënim deri në 3 vjet.

5. Amnistohen personat e dënuar femra, të cilat, në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë baras ose mbi moshën 50 vjeç.

6. Amnistohen personat e dënuar meshkuj, të cilët, në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë baras ose mbi moshën 60 vjeç.

7. Amnistohen personat e dënuar me burgim, të cilët, në kohën e kryerjes së veprës penale, kanë qenë baras ose nën moshën 18 vjeç.

8. Të gjithë të dënuarve femra dhe të mitur, të cilët nuk plotësojnë kriteret për të përfituar amnisti, sipas pikave 2, 4, 5 dhe 7, të këtij neni, u zbritet 1/3 e dënimit të mbetur, pavarësisht kritereve ndaluese të parashikuara në nenin 4 të këtij ligji.

Neni 4
Kriteri ndalues për përfitimin e amnistisë

1. Pavarësisht nga parashikimet e pikave 1, 3 dhe 6, të nenit 3, të këtij ligji, nuk përfitojnë nga kjo amnisti personat e dënuar, për:

a) krime kundër njerëzimit, të parashikuara në nenet 73, 74, 74/a e 75, të Kodit Penal;

b) krime kundër jetës, të kryera me dashje, të parashikuara në nenet 76, 77, 78, 78/a, 79, 79/a, 79/b, 79/c, 81, 82, 83, 83/a, 83/b e 84/a, të Kodit Penal, si dhe në nenin 77, të Kodit Penal Ushtarak;

c) vepra penale të kryera me dashje kundër shëndetit, të parashikuara në nenet 86, 87, 88, 89/a, 96 e 99, të Kodit Penal;

ç) krime seksuale, të parashikuara në nenet 100, 101, 102, 102/a, 103, 104, 105, 106, 107/a, 108 dhe 108/a, të Kodit Penal;

d) vepra penale kundër lirisë së personit, të parashikuara në nenin 109, 109/b, 109/c, në paragrafin e dytë të nenit 110, në nenet 110/a, 110/b, 110/c dhe 111, të Kodit Penal;

dh) vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit, të parashikuara në nenin 114, në paragrafët e dytë dhe të tretë të nenit 117, në nenet 119, 120, 121, të Kodit Penal;

e) vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes, të parashikuara në paragrafin e dytë të nenit 124, në paragrafët e dytë e të tretë të nenit 124/b, në nenet 128/a,128/b, 129 e 130/a, të Kodit Penal;

ë) vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike, të parashikuara në nenin 134, në nenet 135, 136, në paragrafin e dytë të nenit 137/a, në paragrafin e dytë të nenit 138, në nenet 138/a, 139, 140, 141, 141/a, në paragrafët e dytë dhe të tretë të nenit 143, në nenet 143/a, 143/b, 144/a, 151, 152, në paragrafin e dytë të nenit 156, në paragrafin e dytë të nenit 159, në nenet 164/a, 164/b, 175, në paragrafët e dytë dhe të tretë të nenit 180 e në nenin 181/a, të Kodit Penal, si dhe në paragrafët e dytë dhe të tretë të nenit 59 të Kodit Penal Ushtarak;

f) vepra penale kundër falsifikimit të monedhave dhe letrave me vlerë, të parashikuara në nenet 183, 184, në paragrafin e dytë të nenit 185, të Kodit Penal;

g) vepra penale kundër falsifikimit të dokumenteve, të parashikuara në nenin 186, në paragrafin e dytë të nenit 186/a, në paragrafin e dytë të nenit 187, në nenet 188, 189 e 191, në paragrafin e dytë të nenit 192/b, të Kodit Penal;

gj) veprat penale kundër zhvillimit të palejuar të lojërave të fatit, të parashikuara në nenin 197 të Kodit Penal;

h) veprat penale që cenojnë regjimin juridik të tokës dhe të ndërtimeve, të parashikuara në paragrafët e dytë dhe të tretë të nenit 199/a, të Kodit Penal;

i) vepra penale kundër mjedisit, të parashikuara në nenet 201, 202, 203, 206/a, në paragrafin e dytë të nenit 206/b, të Kodit Penal;

j) krime kundër pavarësisë dhe rendit kushtetues, të parashikuara në nenet 208, 209, 210, 211, 212, 213, 214, 215, 216, 217, 218, 219, 220, 221, 222, 223, 224 e 225, të Kodit Penal;

k) krime që cenojnë marrëdhëniet me shtetet e tjera, të parashikuara në nenet 226 e 228, të Kodit Penal;

l) vepra me qëllime terroriste, të parashikuara në nenet 230, 230/a, 230/b, 230/c, 230/ç, 230/d, 231, 232, 232/a, 232/b, 233, 234, 234/a dhe 234/b, të Kodit Penal;

ll) krime kundër autoritetit të shtetit, të parashikuara në paragrafin e dytë të nenit 235, në paragrafin e dytë të nenit 236, në nenet 237, 238, 243, 244, 244/a, 245, 245/1, 248, 248/a, 250, 257/a, 258, 259, 259/a, 260, 265, 265/a, 265/b, 265/c, 266, 267, 270, 274, në paragrafët e parë, të katërt, të pestë, të gjashtë dhe të shtatë të nenit 278, në nenin 278/a, në paragrafin e dytë të nenit 282, në nenin 282/a, në paragrafët e dytë dhe të tretë të nenit 283, në nenet 283/a, 284, 284/a, 284/c, 284/ç, 285, 286, 287, 287/a, 287/b, 288, në paragrafin e dytë të nenit 289, në paragrafët e dytë, të tretë, të katërt të nenit 290, në nenet 293, 293/a, 293/b, 293/c, 294, në paragrafët e parë, të tretë, të pestë dhe të gjashtë të nenit 295/a, në nenet 297, 298, 299, të Kodit Penal, dhe në nenin 70, të Kodit Penal Ushtarak;

m) vepra penale kundër drejtësisë, të parashikuara në paragrafin e dytë të nenit 302, në nenet 305, 305/a, 305/b, 306, në paragrafin e dytë të nenit 309, në nenet 312, 312/a, 313/a, në paragrafët e dytë dhe të tretë të nenit 313/b, në nenet 314, 316, 319, 319/a, 319/b, 319/c, 319/ç, 319/d, 319/dh, 319/e, në nenet 323, 324, 324/a, të Kodit Penal;

n) vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve, të parashikuara në nenet 326, 326/a, 327/a, 328, 328/a, 328/b, 329, 330/a, 331, 331/a, 332 dhe 332/a, të Kodit Penal;

nj) vepra penale të kryera nga banda të armatosura dhe organizata kriminale, të parashikuara në nenet 333, 333/a dhe 334, të Kodit Penal.

2. Pavarësisht nga parashikimet e pikave 2, 4, 5 dhe 7, të nenit 3, të këtij ligji, nuk përfitojnë nga kjo amnisti personat e dënuar për:

a) krime kundër njerëzimit, të parashikuara në nenet 73, 74, 74/a e 75 të Kodit Penal;

b) krime kundër jetës, të kryera me dashje, të parashikuara në nenet 76, 77, 78, 78/a, 79, 79/a, 79/b, 79/c dhe 81 të Kodit Penal;

c) vepra penale të kryera me dashje kundër shëndetit, të parashikuara në nenet 86, 87, në paragrafin e dytë të nenit 88 dhe 89/a, të Kodit Penal;

ç) krime seksuale, të parashikuara në nenet 100, 101, 103, 104, 106, 107/a dhe 108 të Kodit Penal;

d) vepra penale kundër lirisë së personit, të parashikuara në nenet 109, 109/b dhe 110/a, të Kodit Penal;

dh) vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes, të parashikuara në paragrafët e dytë dhe të tretë të nenit 124/b, në nenet 128/a dhe 128/b, të Kodit Penal;

e) vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike, të parashikuara në nenet 139, 140, 141, 151, 152, në paragrafin e dytë të nenit 156 dhe në paragrafin e dytë të nenit 159, të Kodit Penal;

ë) krime kundër pavarësisë dhe rendit kushtetues, të parashikuara në nenet 208, 209, 210, 211, 212, 213, 214, 215, 216, 217, 218, 219, 220, 221, 222, 223, 224 e 225, të Kodit Penal;

f) krime që cenojnë marrëdhëniet me shtetet e tjera, të parashikuara në nenet 226 e 228, të Kodit Penal;

g) vepra me qëllime terroriste, të parashikuara në nenet 233, 234, 234/a dhe 234/b, të Kodit Penal;

gj) krime kundër autoritetit të shtetit, të parashikuara në nenet 237, 238, 265, 265/a, 265/b, 265/c, 266, 274, 278, 278/a ,282/a, 283/a, 284/a, 288 dhe 293, të Kodit Penal;

h) vepra penale të kryera nga banda e armatosur dhe organizata kriminale, të parashikuara në nenet 333, 333/a dhe 334, të Kodit Penal.

3. Nuk përfitojnë nga kjo amnisti personat, të cilët i janë shmangur drejtësisë, sipas përcaktimit të shkronjës "b", të nenit 2, të këtij ligji.

4. Nuk përfitojnë nga kjo amnisti subjektet e përcaktuara në pikat 1, 3 dhe 6, të nenit 3, të këtij ligji, në rast se janë përsëritës të së njëjtës vepër penale.

Neni 5
Të drejtat civile në procesin penal

Nga zbatimi i këtij ligji nuk cenohen të drejtat civile në procesin penal dhe as shpenzimet gjyqësore të kryera gjatë gjykimit deri në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 6
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 30.1.2020.

Shpallur me dekretin nr. 11439, datë 14.2.2020 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

DEKRET
Nr.11439, datë 14.2.2020

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr.5/2020 "Për dhënie amnistie".

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

VENDIM
Nr. 107, datë 13.2.2020

PËR LIRIM NGA DETYRA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Elton Haxhi, zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë, lirohet nga kjo detyrë.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 108, datë 13.2.2020

PËR EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Znj. Vasilika Vjero emërohet zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 109, datë 13.2.2020

PËR EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Znj. Adela Xhemali emërohet zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 111, datë 13.2.2020

PËR EMËRIMIN NË DETYRË TË NJË ANËTARI TË KOMISIONIT KOMBËTAR RREGULLATOR TË SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Emërimin e znj. Elona Kana në detyrën e anëtarit të Komisionit Kombëtar Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e

Përpunimit të Ujërave të Ndotura, për periudhën e mbetur të mandatit, sipas përcaktimit të shkronjës "d", të pikës 3, të nenit 4, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 112, datë 13.2.2020

PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË AGJENCISË SHTETËRORE TË KADASTRËS, TË TRUALLIT ME SIPËRFAQE 620 m² DHE TË NDËRTESËS DYKATËSHE, ME SIPËRFAQE 116 m², PJESË TË PASURISË 1/156, ZONA KADASTRALE 1664, NJËSIA ADMINISTRATIVE FUSHË-KRUJË, BASHKIA KRUJË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 13, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës të truallit me sipërfaqe 620 (gjashtëqind e njëzet) m² dhe të ndërtesës dykatëshe, me sipërfaqe 116 (njëqind e gjashtëmbëdhjetë) m², pjesë të pasurisë 1/156, zona kadastrale 1664, Njësia Administrative Fushë-Krujë, Bashkia Krujë, sipas hartës kadastrale bashkëlidhur këtij vendimi, për ushtrimin e funksioneve administrative të Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Krujë.

2. Agjencisë Shtetërore të Kadastrës i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit të pasurisë së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t'ua japë në përdorim të tretëve.

3. Ngarkohet Agjencia Shtetërore e Kadastrës për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

HARTE KADASTRALE
(Fragment)

AGJENCIA SHTETËRORE
E KADASTRËS

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

ARTAN LAME

Njësia e Kadastrës dhe Hartografisë
Drejtor Andi PROKO

A. IDENTIFIKIMI I PASURISË
ZONA KADASTRALE: 1664 NR.I.PASURISË: 1/156 Vol __ Fq __
INDEKSI I HARTËS: KR-D-3 SHKALLA: 1:500
E-3
ADRESA E PASURISË: FUSHË KRUJË Q/F FUSHË KRUJË
Rr/ I. P/G SH K AP

B. KUFIZIMET
VERI: 1/507
JUG: 1/517
LINDJE: 1/156
PERENDIM: 1/308

C. PRONARI
SHTET

D.Data: 30.10.2019 Ora:

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE KRGJSH



LEGJENDË

Pika	X	Y	Pika	X	Y
1	476875,6 m	4593899,2 m	11	476855,8 m	4593863,4 m
2	476877,9 m	4593898,2 m	12	476857,9 m	4593874,2 m
3	476876,6 m	4593895,3 m	13	476867,8 m	4593892,0 m
4	476868,3 m	4593881,2 m	14	476859,2 m	4593873,3 m
5	476875,7 m	4593877,7 m	15	476865,2 m	4593871,9 m
6	476874,8 m	4593875,6 m	16	476864,6 m	4593869,4 m
7	476894,1 m	4593865,3 m	17	476874,0 m	4593867,2 m
8	476889,1 m	4593864,3 m	18	476872,6 m	4593861,0 m
9	476889,5 m	4593862,8 m	19	476857,2 m	4593864,6 m
10	476864,1 m	4593858,5 m			

Shënim: Sipërfaqia e konturuar me të kuqe është pasuria objekt i Projekt Vendimit.

VENDIM
Nr. 113, datë 13.2.2020

PËR KALIMIN, NË PRONËSI TË BASHKISË PUKË, PËR NJËSINË ADMINISTRATIVE PUKË, TË PASURISË 1/258, ZONA KADASTRALE 3069, ME EMËRTIMIN "GODINË 2 KATE ZYRA", DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 359, DATË 5.6.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME, SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI SHËRBIMIT INFORMATIV SHTETËROR", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 3, shkronja "a", 5, 8 e 17, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin, në pronësi të Bashkisë Pukë, për Njësinë Administrative Pukë, të pasurisë 1/258, zona kadastrale 3069, me emërtimin "Godinë 2 kate zyra", në administrim të Shërbimit Informativ të Shtetit, sipas formularit, gjithsej, 1 (një) fletë, dhe hartës kadastrale, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij, për ushtrimin e funksioneve administrative të Bashkisë Pukë.

2. Pasuria e përmendur në pikën 1, të këtij vendimi, hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, bashkëlidhur vendimit nr. 359, datë 5.6.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Shërbimit Informativ Shtetëror", të ndryshuar.

3. Bashkisë Pukë i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit, të pronës së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t'ua japë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Bashkia Pukë, Shërbimi Informativ i Shtetit dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

HARTE KADASTRALE
(Fragment)



1. FORMULARI PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUJTSHME SHTETERORE
(Per inventarizimin e pronave te veçanta)

Institucioni I Pushtetit Qendror SHERBIMI INFORMATIV I SHTETIT — Identifikoi Xhelal Abedini, Inspektor Dege, Yili Koxhaj ing. Ndertimi (Emri, Mbiemri, pozicioni zyrtar)
Bashkia PUKE — Supervizoi Bardhyl Rrapaj Drejtor i Drejtorise Ekonomike (Emri, Mbiemri, pozicioni zyrtar)
Fusha e Perdorimit te prones ZYRA DHE AMBIENTE TE TJERA NDIHMESE — Aprovoi Petrit Myftari I Ngarkuar ligjor me detyren e Drejtorit te Sh.I.SH.I (Emri, Mbiemri, pozicioni zyrtar, tel, firma, vula)

Nr. Rend.	A			B			C			
	Zona Kadast.& Indeksi I hartes	Nr. Pasurise	Lloji I Prones	Emri I Prones / Adresa	Sip. totale e prones (m2)	Nga Sip. totale se nderte. (m2)	Funksioni per te cilin perdoret prona	Institucioni / Enti me prgjegjesi administrative	Institucioni / Enti perdorues Statusi juridik I perdorimit	Te dhenata tjera (Shenime te veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	Z.K 3069 Indeksi hartes P4D3	eshte ne proces regjistrimi	zyra	Godine 2 kat zyra Adresa: Ish kursi I partise PUKE	774.6	258.8	zyra & ambiente sherbimi	Drejtoria SHISH SHKODER	SH.I.SH	

VENDIM
Nr. 114, datë 13.2.2020

PËR KALIMIN NË PRONËSI NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE BASHKIA VLORË, TË NJË PJESE TË TRUALLIT FUNKSIONAL BRENDA TERRITORIT TË PRONËS NR. 912, ME EMËRTIM "SHTËPIA E USHTARAKËVE", ME VENDNDODHJE NË VLORË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, dhe të neneve 3, 5, 7, 8 e 17, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi nga Ministria e Mbrojtjes te Bashkia Vlorë, të një sipërfaqeje trualli funksional, me sipërfaqe të përgjithshme prej 400 (katërqind) m², nga trualli funksional i pronës nr. 912, me emërtim "Shtëpia e ushtarakëve", me vendndodhje në Vlorë, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, sipas planrilevimit, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për ta përdorur për nevoja urbanistike, ndërtim rruge publike.

2. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes", të ndryshuar, të hiqet prona nr. 912, me emërtim "Shtëpia e ushtarakëve", me vendndodhje në Vlorë. Sipërfaqja truall funksional, me sipërfaqe të përgjithshme prej 400 (katërqind) m², pjesë e pronës, sipas planrilevimit, të shtohet në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të Bashkisë Vlorë, miratuar me vendimin nr. 639, datë 29.9.2007, të Këshillit të Ministrave.

3. Bashkisë Vlorë i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit të sipërfaqes së pronës, të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t'ua japë atë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Agjencia e Shtetërore e Kadastrës dhe Bashkia Vlorë për ndjekjen e zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Verteldiet me origjinalin

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURISË SË PALUAJTSHME

ÇERTIFIKATË 1358679
PËR VËRTETIM PRONËSIE

Zyra e Regjistrimit Z.V.R.P.P. VLORË Zona Kadastrale Nr. 8605
Numri i Pasurisë 50/17 Volumi 12 Faqe 88
Adresa e Pasurisë VLORË
Lloji i Pasurisë TRUALL
Sipërfaqja Totale 1673.00 m2
Nga kjo : Sa Truall 1,673.00 Nga kjo : Sa Ndërtesa 795.00
Nqs pallat : Kuota e pjesëmarrjes - %

KJO ÇERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË

Zoti (Zotërinjtë)

Emri	Atësia	Mbiemri	Pjesa	Adresa
SHTET			1/1	VLORË

- është pronar i pasurisë me numër 50/17
- janë bashkëpronarë sipas pjeseve më lart
- është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi
- kufizimet e pasurisë janë : V , L , J , P

Kjo çertifikatë plotësohet në përputhje me Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Kjo çertifikatë lëshohet sipas kërkesës së paraqitur nga i (të) interesuari (t) më datë 22/2/2017 Nr. 4709

Data e lëshimit të çertifikatës 2/3/2017

Lëshuesi i çertifikatës
REGJISTRUESI
(REZART ELMAZI)



VENDIM
Nr. 115, datë 13.2.2020

PËR DHËNIEN E NDIHMËS SË MENJËHERSHME FINANCIARE PUNONJËSIT TË SHËRBIMIT TË MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN, NË RAST TË DËMTIMIT TË RËNDË TË PRONËS, PËR SHKAK TË DETYRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikave 1, shkronja "c", dhe 2, të nenit 31, të ligjit nr. 152/2015, "Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin", me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Punonjësi me gradë i Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, në vijim punonjësi, përfiton ndihmë të menjëhershme financiare në rastet kur prona e luajtshme apo e paluajtshme i është dëmtuar si pasojë e veprës penale, të kryer në dëm të tij për shkak të detyrës dhe për rastin është referuar në prokurori.

2. Punonjësi, në rast të dëmtimit të rëndë të pronës së luajtshme apo paluajtshme për shkak të detyrës, përfiton ndihmë të menjëhershme financiare në masën 100% të vlerës së pronës së dëmtuar, por jo më shumë se 1 000 000 (një milion) lekë.

3. Për të përfituar ndihmë të menjëhershme financiare, punonjësi duhet të disponojë titull pronësie, bashkëpronësie apo dokument që vërteton procesin e legalizimit të pronës së dëmtuar.

4. Punonjësit i jepet ndihmë e menjëhershme financiare, sipas këtij vendimi, vetëm në rast se nuk ka përfituar dëmshpërblim nga shoqëritë e sigurimit, sipas legjislacionit për veprimtarinë e sigurimit dhe të risigurimit.

5. Për përfitimin e ndihmës së menjëhershme financiare, punonjësi paraqet kërkesë zyrtarisht pranë kryetarit të bashkisë përkatëse, shoqëruar nga dokumentacioni që kërkohet sipas këtij vendimi.

6. Kryetari i bashkisë përkatëse urdhëron, brenda 5 (pesë) ditëve nga paraqitja e kërkesës së

punonjësit, ngritjen e Komisionit të Verifikimit të Faktit dhe Vlerësimin e Dëmit, në vijim Komisioni, në përbërje të të cilit duhet të ketë edhe specialistë të vlerësimit të pronave të luajtshme apo të paluajtshme.

7. Komisioni verifikon faktin e dëmtimit të pronës, sipas pikës 1, të këtij vendimi, bën vlerësimin e dëmit të shkaktuar dhe i paraqet kryetarit të bashkisë, jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga miratimi i urdhrit për ngritjen e tij, dokumentacionin, si më poshtë vijon:

a) procesverbalin, i cili duhet të përmbajë rekomandimet përkatëse;

b) kërkesën me shkrim të punonjësit të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin;

c) kopje të njësuar me origjinalin të shkresës për referim të veprës penale në prokurori;

ç) dokumentacionin që provon titullin e pronësisë, bashkëpronësisë, apo procesin e legalizimit, mbi pronën e dëmtuar;

d) çdo dokument të administruar nga Komisioni.

8. Ndihma e menjëhershme financiare jepet me urdhër të kryetarit të bashkisë, bashkëlidhur të cilit duhet të jetë dokumentacioni i administruar nga Komisioni.

9. Nëse provohet që ndihma e menjëhershme financiare është dhënë në kundërshtim të përcaktimeve të këtij vendimi ose në vendimin e organit procedues rezulton se dëmi i shkaktuar nuk ka ardhur për shkak të detyrës, punonjësi është i detyruar të kthejë në masën 100% shumën e përfituar.

10. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi përballohen nga buxheti i njësive të vetëqeverisjes vendore.

11. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 117, datë 13.2.2020

PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË AGJENCISË SHTETËRORE TË KADASTRËS, PËR VITIN 2020

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 111/2018, "Për kadastrën", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e programit buxhetor të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, për vitin 2020, sipas shtojcës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Miratimin e buxhetit të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, për vitin 2020, sipas shtojcave nr. 2 e nr. 3, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

3. Ngarkohet Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.1.2020.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

SHTOJCË NR. 1
PEMA E PROGRAMIT PËR VITIN 2020 PËR AGJENCINË SHTETËRORE TË KADASTRËS



SHTOJCË NR. 2

mijë/lekë

Përshkrimi	Buxheti janar-dhjetor 2020	
	Të ardhura	Shpenzime
Të ardhura në total	4,289,575	
Shpenzime në total		3,391,612
Transferta ATP		484,730
Fondi rezervë		104,700
Fondi i pashpërndarë		308,533
TOTALI	**4,289,575**	**4,289,575**

SHTOJCË NR. 3

mijë/lekë

Nr.	EMËRTIMI	BUXHETI 2020
I	**TOTALI I TË ARDHURAVE**	**4,289,575**
1	**Të ardhura nga shërbimet**	1,640,000
2	**Të ardhura nga transferimi i parcelës ndërtimore**	688,430
3	**Të ardhura të tjera**	96,300
4	**Të ardhura që trashëgohen nga viti 2019**	1,864,845
II	**TOTALI I SHPENZIMEVE**	**4,289,575**
1	**TOTALI I SHPENZIMEVE TË PERSONELIT**	**1,793,561**
	Shpenzime personeli organik	948,609
	Kontribute për sigurime shoqërore për punonjësit në organikë	157,236
	Shpenzime personeli me kontratë	548,660
	Kontribute për sigurime shoqërore për punonjësit me kontratë	91,626
	Fondi i veçantë i pagave	47,430
2	**TOTALI I SHPENZIMEVE KORENTE**	**580,000**
	Shpenzime operative nga të cilat:	580,000
	Shpenzime për mallra dhe shërbime	*430,000*
	Shpenzime të planifikuara për gjyqin e arbitrazhit	*150,000*
3	**TOTALI I SHPENZIMEVE KAPITALE**	**1,018,051**
	Investime kapitale të patrupëzuara nga të cilat:	410,761
	Drejtoria e Projektit të përmirësim-përditësimit (300)	*303,000*
	Shpenzime për investime të tjera të patrupëzuara	*107,761*
	Investime kapitale të trupëzuara	607,290
4	**Fondi i transferuar për ATP-në**	**484,730**
5	**Fondi rezervë**	**104,700**
6	**Fonde të pashpërndara**	**308,533**
	TË ARDHURA (-) SHPENZIME	**0**

VENDIM
Nr. 118, datë 13.2.2020

PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS SË VLERËSIMIT TË KONTRIBUTIT TË DONACIONEVE NË FORMËN E PASURIVE TË PALUAJTSHME

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës "p", të pikës 1, të nenit 21, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në zbatim të shkronjës "p", të pikës 1, të nenit 21, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar, vlera e pasurive të paluajtshme të dhuruara për rastet e shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore, sipas parashikimeve në ligjin nr. 97/2019, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", njihet si shpenzim i njohur, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

2. Në zbatimin e këtij vendimi, termi "fatkeqësi natyrore" ka të njëjtin kuptim sipas përcaktimit në ligjin nr. 97/2019, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësive natyrore".

3. Për pasuritë e paluajtshme të dhuruara nga tatimpaguesit që janë subjekt i tatimit mbi fitimin apo i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, vlera e pasurive të paluajtshme, për efekt të llogaritjes së masës së nivelit të shpenzimeve të njohur, konsiderohet vlera kontabël neto, e pasqyruar në bilancin e shoqërisë përpara momentit të dhurimit, minus shumën e amortizuar deri në periudhën e dhurimit.

4. Për pasuritë e paluajtshme të dhuruara nga tatimpaguesit që janë subjekt i tatimit mbi fitimin apo i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, të rivlerësuara më parë, vlera e pasurive të paluajtshme, për efekt të llogaritjes së masës së nivelit të shpenzimeve të njohur, konsiderohet vlera e rivlerësuar, për të cilën është paguar tatimi, sipas akteve ligjore në fuqi në momentin e rivlerësimit të pasurisë së paluajtshme.

5. Për pasuritë e paluajtshme të dhuruara, tatimpaguesit duhet të disponojnë dokumentacionin e fitimit të pronësisë.

6. Në rastet kur pasuria e paluajtshme, e regjistruar në bilancin e shoqërisë, është e ndërtuar nga vetë shoqëria apo nga një nënkontraktor, si shoqëri ndërtuese, si vlerë e pasurisë do të konsiderohet vlera e investimit e dorëzuar në organet e pushtetit vendor për efekt të llogaritjes së taksës së ndikimit në infrastrukturë.

7. Vlera e pasurive të paluajtshme të dhuruara nga institucionet financiare bankare dhe jobankare, për efekt të përllogaritjes së shpenzimit të njohur para tatimit, konsiderohet vlera e pasqyruar në aktivet e bilancit të këtyre institucioneve në momentin e fitimit të aktit të pronësisë, sipas legjislacionit të fushës.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 119, datë 13.2.2020

PËR PROCEDURAT E PAGESËS DHE TË RIVLERËSIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME QË JANË NË PROCES REGJISTRIMI, DUKE PËRFSHIRË EDHE PASURITË E LEGALIZUARA, NË PËRPUTHJE ME LIGJIN NR. 90/2019, "PËR RIVLERËSIMIN E PASURISË SË PALUAJTSHME"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 2, të ligjit nr. 90/2019, "Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME PËR RIVLERËSIMIN E PASURISË SË PALUAJTSHME NË PROCES REGJISTRIMI PËR INDIVIDËT

1. Të gjithë individët dhe personat juridikë, të cilët kanë në proces regjistrimi pasuri të

paluajtshme (tokë dhe/ose ndërtesë) pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (në vijim "ASHK"), përshirë edhe lejet e legalizimit, sipas ligjit nr. 111/2018, "Për kadastrën", apo do të aplikojnë për regjistrimin e tyre brenda datës 30.9.2020, kanë të drejtë që, brenda këtij afati, të bëjnë rivlerësimin e kësaj pasurie me vlerën e tregut, sipas ligjit nr. 90/2019, "Për rivlerësimin e pasurive të paluajtshme".

2. Individi mund të zgjedhë vullnetarisht nëse rivlerësimin e pasurisë do ta bëjë ASHK-ja apo një ekspert i vlerësimit të pasurive, i licencuar nga institucionet përkatëse. Për të përfituar nga rivlerësimi, nëpërmjet pasqyrimit të tij në regjistrin e pasurive të paluajtshme, individi duhet të paguajë më parë tatimin e rivlerësimit (3 (tre) % e bazës së tatueshme) dhe tarifën e shërbimit.

3. Në rast se individi ka aplikuar apo do të aplikojë, brenda datës 30.9.2020, për të regjistruar më shumë se një pasuri të paluajtshme dhe do të bëjë rivlerësimin e secilës prej tyre, procedura e rivlerësimit është individuale për secilën prej këtyre pasurive.

4. ASHK-ja vijon me trajtimin e aplikimit për rivlerësimin e pasurisë në proces regjistrimi dhe llogaritjen e tatimit 3%, nëse dokumentacioni i paraqitur për regjistrimin e pasurisë në regjistrat e pasurive të paluajtshme është në përputhje me ligjin nr. 111/2018, "Për kadastrën".

II. LLOGARITJA E BAZËS SË TATUESHME PËR RIVLERËSIMIN E PASURISË NË PROCES REGJISTRIMI PËR INDIVIDËT

5. Në rast se individi zgjedh që rivlerësimin e pasurisë ta bëjë drejtoria vendore e ASHK-së, kjo do të bëhet me çmimet referuese të përcaktuara në aktet nënligjore në fuqi, në momentin e kryerjes së procesit të rivlerësimit të pasurisë në proces regjistrimi dhe sipas përcaktimeve të udhëzimit nr. 29, datë 30.7.2018, "Për tatimin e kalimit të së drejtës së pasurisë së paluajtshme", dhe konkretisht:

5.1 Nëse pasuria në proces regjistrimi nuk ka të përcaktuar vlerën në aktin e fitimit të pronësisë, atëherë baza e tatueshme llogaritet si diferencë ndërmjet vlerës së rivlerësimit, sipas çmimeve referuese, në përputhje me aktin nënligjor në fuqi, dhe vlerës së zbritshme. Në këtë rast, si vlerë e zbritshme për ndërtesat do të merret vlera e kostos së shfrytëzimit për metër katror, e përcaktuar nga akti nënligjor në fuqi (udhëzimi përkatës i Këshillit të Ministrave), në momentin e aplikimit për regjistrim të pasurisë së paluajtshme. Ndërkohë, si vlerë e zbritshme për tokën do të merret vlera sipas çmimeve të hartës së vlerave në fuqi, korrektuar me indeksin e inflacionit, sipas udhëzimit nr. 29, datë 30.7.2018, "Për tatimin e kalimit të së drejtës së pronësisë së pasurisë së paluajtshme".

5.2 Nëse pasuria në proces regjistrimi ka të përcaktuar vlerën në aktin e fitimit të pronësisë, atëherë baza e tatueshme llogaritet si diferencë ndërmjet vlerës së rivlerësimit, llogaritur me çmimet referuese, sipas aktit nënligjor në fuqi, dhe vlerës së pasurisë së pasqyruar në aktin përkatës të fitimit të pronësisë që evidenton pasurinë e paluajtshme.

6. Në rast se individi zgjedh që rivlerësimin e pasurisë ta bëjë një ekspert i licencuar, kur:

6.1 Pasuria në proces regjistrimi nuk ka të përcaktuar vlerën në aktin e fitimit të pronësisë, atëherë baza e tatueshme llogaritet si diferencë ndërmjet vlerës së pasqyruar në aktin e vlerësimit nga vlerësuesi (eksperti), me vlerën sipas kostos së shfrytëzimit për metër katror, e përcaktuar nga akti nënligjor në fuqi (udhëzimi përkatës i Këshillit të Ministrave) në momentin e aplikimit për regjistrim të pasurisë së paluajtshme. Ndërkohë, si vlerë e zbritshme për tokën do të merret vlera, sipas çmimeve të hartës së vlerave në fuqi, korrektuar me indeksin e inflacionit, sipas udhëzimit nr. 29, datë 30.7.2018, "Për tatimin e kalimit të së drejtës së pronësisë së pasurisë së paluajtshme".

6.2 Pasuria në proces regjistrimi ka të përcaktuar vlerë në aktin e fitimit të pronësisë, atëherë baza e tatueshme llogaritet si diferencë ndërmjet vlerës së pasqyruar në aktin e vlerësimit nga vlerësuesi (eksperti) dhe vlerës së pasurisë së pasqyruar në aktin përkatës të fitimit të pronësisë që evidenton pasurinë e paluajtshme.

7. Si moment për llogaritjen e bazës së tatueshme për pasuritë, të cilat janë në proces regjistrimi, do të konsiderohet data e aplikimit për regjistrim në ASHK.

III. PARAQITJA DHE ADMINISTRIMI I KËRKESËS PËR RIVLERËSIMIN E PASURISË NË PROCES REGJISTRIMI NGA INDIVIDËT

A. Aplikimi *online*

8. Individi ose përfaqësuesi i tij aplikon *online* për shërbimin e rivlerësimit të pasurisë në proces regjistrimi, nëpërmjet portalit qeveritar *e-Albania*. Në mënyrë që të pajiset me dokumentin zyrtar, që pasqyron regjistrimin e rivlerësimit, ai duhet të aplikojë edhe për shërbimin e pajisjes me kopje të kartelës së pasurisë së paluajtshme, ose të vërtetimit (për pasuritë që nuk i janë nënshtruar regjistrimit fillestar).

Aplikimi për shërbimet i drejtohet drejtorisë/zyrës vendore të ASHK-së që është kompetente për territorin ku po regjistrohet pasuria e paluajtshme.

9. Individi që aplikon *online* për rivlerësimin e pasurisë në proces regjistrimi duhet të plotësojë në rubrikat përkatëse të platformës *e-Albania* të dhënat identifikuese të pasurisë në proces regjistrimi që kërkohet të rivlerësohet. Nëse individi nuk plotëson rubrikat që identifikojnë pasurinë, ai duhet detyrimisht të ngarkojë në platformë kopje të skanuar të dokumentit të pronësisë që disponon për pasurinë.

10. Punonjësi i drejtorisë vendore të ASHK-së shqyrton aplikimin, duke verifikuar:

a) identifikimin e pasurisë, sipas përcaktimeve të pikës 9, të këtij kreu; dhe

b) legjitimimin e individit aplikues. Punonjësi verifikon nëse individi që ka paraqitur kërkesën për rivlerësim (ose i përfaqësuari) është pronar apo një nga bashkëpronarët e pasurisë që kërkohet të rivlerësohet;

c) nëse dokumentacioni i paraqitur për pasurinë në proces regjistrimi është në përputhje me ligjin nr. 111/2018, "Për kadastrën".

Nëse nuk përmbushen kushtet e mësipërme, individi njoftohet nëpërmjet platformës, për të identifikuar pasurinë ose për mosvijimin e aplikimit me arsyet përkatëse.

11. Nëse aplikimi i përmbush kushtet e pikës 10, të këtij kreu, dhe dokumentacioni i regjistrimit të pasurisë është në përputhje me ligjin nr. 111/2018, vijohet me llogaritjen e tatimit të rivlerësimit, sipas rregullave të kreut II, të këtij vendimi, duke hartuar faturën për arkëtim.

12. Fatura për arkëtim plotësohet sipas modelit të shtojcës nr. 3 që i bashkëlidhet vendimit dhe është pjesë përbërëse e tij. Fatura nënshkruhet dhe vuloset elektronikisht nga drejtoria vendore e ASHK-së dhe, së bashku me tarifat e shërbimit, i dërgohet aplikuesit nëpërmjet portalit qeveritar *e-Albania*.

13. Përjashtimisht, kur individi kërkon rivlerësimin, sipas aktit të ekspertit të licencuar, dërgimi, nëpërmjet platformës, i faturës së tatimit të nënshkruar dhe të vulosur elektronikisht, së bashku me tarifën e shërbimit, kryhet vetëm pasi të jetë administruar fizikisht (me postë) akti origjinal i vlerësimit të pasurisë, nënshkruar dhe vulosur nga eksperti vlerësues i pasurisë, si dhe fotokopja e njësuar e licencës së tij. Për këtë, individi, krahas aplikimit *online*, duhet të dërgojë me postë në zyrën/drejtorinë vendore të ASHK-së dokumentacionin fizik të mësipërm.

14. Pasi të jetë verifikuar shlyerja e pagesës së tatimit të rivlerësimit dhe të tarifave të shërbimit, aplikimi i individit konsiderohet i plotësuar dhe ASHK-së i lind detyrimi që, përveç regjistrimit të pasurisë në regjistrat e pasurive të paluajtshme, të bëjë edhe pasqyrimin e rivlerësimit në regjistrin e pasurive, sipas rregullave të parashikuara në kreun VI, të këtij vendimi.

B. Aplikimi në sportel

15. Përjashtimisht, në rastet kur është e pamundur të administrohet aplikimi nëpërmjet portalit qeveritar *e-Albania*, aplikimi kryhet pranë zyrës pritëse (sportelit) në drejtorinë/zyrën vendore kompetente ku është në proces regjistrimi i pasurisë, duke paraqitur "Kërkesën për rivlerësim", sipas formularit, shtojca nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Në mënyrë që të pajiset me dokumentin zyrtar që pasqyron regjistrimin e rivlerësimit, individi duhet të aplikojë edhe për shërbimin e pajisjes me kopje të kartelës së pasurisë së paluajtshme ose të vërtetimit (për pasuritë që nuk i janë nënshtruar regjistrimit fillestar).

16. Individi apo përfaqësuesi i tij me prokurë, në çdo rast, paraqitet me dokument identifikimi pranë zyrës pritëse të ASHK-së. Ai pajiset me dy kopje të paplotësuara të formularit "Kërkesë për rivlerësim" nga punonjësi përgjegjës.

16.1 Individi apo përfaqësuesi i tij me prokurë plotëson dy pikat e para të formularit. Të dhënat e plotësuara në formular dhe në dokumentacionin bashkëlidhur (kopje të dokumentit të pronësisë) verifikohen sipas përcaktimeve të pikës 10, të kreut III, të këtij vendimi.

16.2 Në rast përputhjeje të të dhënave, punonjësi përgjegjës plotëson pikën 3, të formularit, me vlerën e zbritshme.

16.3 Punonjësi llogarit tatimin që paguhet për regjistrimin e këtij rivlerësimi, sipas kreut II, të këtij vendimi, duke plotësuar pikën 4, të formularit, "Kërkesë për rivlerësim".

16.4 Pas plotësimit të të gjitha pikave të mësipërme të formularit "Kërkesë për rivlerësim", punonjësi përgjegjës e nënshkruan atë dhe një kopje ia jep individit ose përfaqësuesit të tij. Individi ose përfaqësuesi i tij, pajiset gjithashtu me faturën për arkëtim (shtojca nr. 3) për pagesën e tatimit, si dhe për tarifat e shërbimit.

16.5 Individi, pasi paguan në bankë tatimin dhe tarifën e shërbimit, dorëzon vërtetimin e pagesës së tyre pranë drejtorisë vendore të ASHK-së. Vërtetimi i pagesës i bashkëlidhet formularit të aplikimit.

16.6 Pas kryerjes së pagesës së tatimit dhe tarifave të shërbimit, aplikimi konsiderohet i plotësuar dhe drejtorisë vendore i lind detyrimi që, përveç regjistrimit të pasurisë në regjistrat e pasurive të paluajtshme, të bëjë edhe pasqyrimin e rivlerësimit në regjistrin e pasurive, sipas rregullave të parashikuara në kreun VI, të këtij vendimi.

IV. RIVLERËSIMI I PASURISË SË PALUAJTSHME NË PROCES REGJISTRIMI PËR PERSONAT JURIDIKË

17. Personat juridikë, të cilët kanë të regjistruara në pasqyrat financiare të vitit 2019, në zërin "aktive afatgjata materiale", pasuri të paluajtshme me vlerë kontabël më të vogël se vlera e tregut, dhe janë në proces regjistrimi të tyre në regjistrat e pasurive të paluajtshme pranë ASHK-së, kanë të drejtë të bëjnë, brenda periudhës së zbatimit të këtij ligji, rivlerësimin e këtyre pasurive të paluajtshme me vlerën e tregut. Rivlerësimi me vlerën e tregut bëhet nga vlerësues të pasurisë, ekspertë të pavarur të licencuar nga institucionet përkatëse për vlerësimin e pasurisë së paluajtshme.

18. Procedura e rivlerësimit të pasurive të paluajtshme në proces regjistrimi të personave juridikë kryhet, si më poshtë vijon:

18.1 Përfaqësuesi i personit juridik paraqet pranë drejtorisë rajonale tatimore, ku personi juridik është i regjistruar, këto dokumente:

a) deklarimin vullnetar për rivlerësimin e pasurisë, sipas shtojcës nr. 2 që i bashkëlidhet këtij vendimi;

b) prokurën për përfaqësuesin ligjor, nëse kjo procedurë kryhet nga një përfaqësues ligjor i caktuar prej tij;

c) kopjen e licencës së ekspertit të pavarur të vlerësimit të pasurisë;

ç) kopjen e faturës së shërbimit të ekspertit të vlerësimit të pasurisë;

d) aktin origjinal të vlerësimit të pasurive të paluajtshme, të nënshkruar dhe të vulosur nga vlerësuesi i pasurisë;

dh) dokumentin e lëshuar nga drejtoria vendore e ASHK-së, ku evidentohet se pasuria e paluajtshme e personit juridik që rivlerësohet është në proces regjistrimi pranë kësaj drejtorie;

e) pasqyrën financiare (bilancin kontabël) të vitit 2019, ku rezulton e regjistruar në zërin "aktive afatgjata materiale", pasuria e paluajtshme që rivlerësohet, përfshirë anekset shpjeguese për aktivin afatgjatë material që rivlerësohet;

ë) kopjen e mandatit të pagesës për vlerësimin e pasurisë, në masën 5 (pesë) % të diferencës ndërmjet vlerës së rivlerësimit dhe vlerës kontabël për pasuritë e paluajtshme të regjistruara në pasqyrat financiare. Pagesa kryhet në njërën nga bankat e nivelit të dytë për llogari të thesarit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, sipas formatit të faturës së arkëtimit, shtojca nr. 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Personi juridik mban një kartelë të pasurisë së paluajtshme, ku evidenton vlerën përkatëse të pasurisë së paluajtshme që nga momenti i njohjes fillestare të aktivit dhe tatimin përkatës, paguar sipas legjislacionit në fuqi.

18.2 Data e rivlerësimit të pasurive të paluajtshme konsiderohet data e pagesës së kryer, siç përcaktohet në pikën 4, të nenit 3, të ligjit nr. 90/2019.

18.3 Diferenca midis vlerës që rezulton nga rivlerësimi, sipas aktit përkatës të ekspertit dhe vlerës kontabël të regjistruar në pasqyrat financiare regjistrohet përkatësisht në zërin përkatës të pasqyrave financiare, në përputhje me ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", të ndryshuar, si dhe në përputhje me ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar. Kjo vlerë nuk është objekt amortizimi për qëllime tatimore.

18.4 Pasqyrave financiare për rivlerësimet që kryhen brenda periudhës gjatë së cilës i shtrin efektet ligji nr. 90/2019, sipas nenit 5, të tij, u

bashkëlidhen pasqyrat analitike të vlerës kontabël të pasurive të paluajtshme të rivlerësuara.

V. PAGESA E TË ARDHURAVE NGA RIVLERËSIMI I PASURISË SË PALUAJ-TSHME NË PROCES REGJISTRIMI NË BUXHETIN E SHTETIT

19. Pagesa e tatimit nga rivlerësimi i pasurive të paluajtshme në proces regjistrimi kryhet pranë bankave të nivelit të dytë, sipas formularit "Fatura për arkëtim", sipas modelit të shtojcës nr. 3 dhe të shtojcës nr. 4, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

20. Formulari u vihet në dispozicion klientëve-individë nga drejtoritë/zyrat vendore të ASHK-së dhe klientëve-persona juridikë nga drejtoritë rajonale tatimore. Gjithashtu, ky formular mund të shkarkohet edhe elektronikisht në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

21. Fatura për arkëtim, e plotësuar sipas këtij vendimi, nënshkruhet nga klienti. Për personin juridik është e detyrueshme që, përveç të dhënave të nënshkruesit, të plotësohen gjithashtu emri i personit juridik (shoqërisë) dhe NIPT-i/NUIS-i. Pas verifikimit për plotësimin e të dhënave të plota, banka, në zbatim të marrëveshjes dypalëshe me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, pranon të kryejë arkëtimin, duke evidentuar llojin e të ardhurës, si dhe kodin e institucionit, sikurse është përcaktuar në "Faturën për arkëtim", në bazë të kodit të të cilit do të kryhet kontabilizimi në sistemin informatik financiar të qeverisë (në vijim "SIFQ").

22. Arkëtimi i këtyre të ardhurave do të kryhet në llogarinë bankare të të ardhurave të thesarit, në emër të institucionit të drejtorisë/të zyrës vendore të ASHK-së. Drejtoritë/zyrat vendore të ASHK-së do të operojnë si agjentë tatimorë për arkëtimin në buxhetin e shtetit të këtyre të ardhurave. Për këtë qëllim, në SIFQ do të çelen kodet e institucionit në grupin 80 për çdo drejtori/zyrë vendore të ASHK-së. Kontabilizimi i tatimit nga rivlerësimi i pasurisë së personave juridikë (5%) do të bëhet në llogarinë ekonomike të të ardhurave 7020400, ndërsa kontabilizimi i tatimit nga rivlerësimi i pasurisë së individëve (3%) do të bëhet në llogarinë ekonomike të të ardhurave 7020800.

23. Banka transferon arkëtimet në llogaritë bankare përkatëse, në emër të Degës së Thesarit të çdo rrethi për çdo drejtori vendore, sipas kodeve përkatëse të çdo drejtorie.

24. Drejtoritë/zyrat vendore të ASHK-së çdo muaj bëjnë rakordimin me degën e thesarit për arkëtimet e kryera, në përputhje me këtë vendim.

25. Në raste të derdhjeve gabim dhe të detyrimit për të kthyer sërish ose pjesërisht shumën e derdhur gabim, drejtoria vendore e ASHK-së do të paraqesë urdhërpagesën së bashku me dokumentet justifikuese pranë degës së thesarit respektive për kthimin e shumës tek individi/personi juridik përfitues i kësaj shume. Për këtë qëllim, çdo drejtori vendore e ASHK-së duhet të miratojë në strukturën përgjegjëse të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nëpunësin e saj autorizues dhe atë zbatues, për nënshkrimin e urdhërpagesës, si dhe depozitimin e firmave të autorizuara në degën e thesarit.

VI. TARIFA E KRYERJES SË SHËRBIMIT DHE DISPOZITA TË TJERA

26. Tarifa për kryerjen e shërbimit të rivlerësimit pranë ASHK-së, për pasuritë e paluajtshme në proces regjistrimi, është në masën 1 200 (një mijë e dyqind) lekë dhe do të ketë kodin RVP në formularin e aplikimit.

27. Procedurat për pasqyrimin e rivlerësimit të pasurisë, në proces regjistrimi në regjistrat e pasurive të paluajtshme, kryhen sipas dispozitave të përcaktuara në udhëzimin e përbashkët të ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe të drejtorit të Përgjithshëm të ASHK-së, "Për procedurat e zbatimit të ligjit nr. 90/2019, "Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme" dhe përcaktimin e tarifës së shërbimit".

28. Aplikimet për rivlerësim të pasurive që janë në proces regjistrimi, për të cilat është shlyer tatimi brenda datës 30.9.2020, trajtohen e përfundohen edhe pas kësaj date.

29. Ngarkohen Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

SHTOJCË NR. 1
FORMULAR "KËRKESË PËR RIVLERËSIM" (PËR INDIVIDËT)

Drejtuar: Drejtorisë/zyrës vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës
_____

1. Të dhënat e aplikuesit
Emri/atësia/mbiemri i aplikuesit:_____
Numri i identifikimit në kartën e identitetit _____, lëshuar nga _____
Data e lëshimit:_____
Adresa e banimit_____, adresa e dytë (nëse ka)_____

2. Të dhënat e pasurisë së paluajtshme
Në përputhje me ligjin nr. 90/2019, "Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme", aplikoj për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme.
Lloji i pasurisë së paluajtshme (tokë/ndërtesë)
Numri i regjistrimit në zyrën kadastrale_____, sipërfaqja në m² (me shifra dhe me fjalë)
m²_____
Data e regjistrimit në ASHK:_____
Çmimi i blerjes së pasurisë, bazuar në kontratën e shitblerjes/vlera e rivlerësuar për të cilën është paguar tatimi _____
_____
(me shifra dhe me fjale për t'u plotësuar nga ASHK-ja)

3. Rivlerësimi i pasurisë së paluajtshme
3.1 Në rast se kryhet nga ASHK-ja
Vlera e pasurisë në vitin 2020, sipas çmimeve minimale fiskale ne fuqi
_____
(në shifra dhe me fjalë)

3.2 Në rast se kryhet nga eksperti i pasurisë
Vlera e pasurisë në vitin 2020, sipas aktit të ekspertimit
_____
(me shifra dhe me fjalë)

4. Tatimi për t'u paguar
4.1 Baza e tatueshme = (vlera e dalë nga rivlerësimi me çmimet minimale fiskale në fuqi minus vlerën e pasurisë së aktit të regjistruar apo vlerën e rivlerësuar për të cilën është paguar tatimi)
_____
Tatimi = (3% e bazës së tatueshme)

4.2 Baza e tatueshme = (vlera e tregut të pasurisë së pasqyruar në akt ekspertimi (jo më e vogël se çmimi minimal fiskal) minus vlerën e pasurisë, sipas aktit të regjistruar apo vlerës së rivlerësuar për të cilën është paguar tatimi)
_____
Tatimi = (3% e bazës së tatueshme)

Data dhe nënshkrimi i aplikuesit:_____
Aplikimi është marrë nga personi i autorizuar nga ASHK-ja:
_____

SHTOJCË NR. 2
DEKLARIMI VULLNETAR PËR RIVLERËSIMIN E PASURIVE TË PALUAJTSHME TË PERSONAVE JURIDIKË

Drejtuar: Drejtorisë Rajonale të Tatimeve:_____

Deklarim vullnetar për rivlerësimin e pasurive të paluajtshme

Unë znj/z_____ përfaqësuesi i personit juridik_____
me NIPT/NUIS_____, me adresë _____,pajisur me autorizim për përfaqësim_____, deklaroj se, në bazë të ligjit nr. 90/2019, "Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme", deklaroj vullnetin tim për të kryer rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme të regjistruar në pasqyrën financiare (bilanci kontabël) të periudhës_____.

Baza e tatueshme = (diferenca midis vlerës që rezulton nga rivlerësimi, sipas aktit të ekspertit dhe vlerës kontabël të regjistruar në pasqyrat financiare (në shifra dhe fjalë))

_____

Pagesa =5% x bazën e tatueshme_____

Emri/mbiemri: _____
(nënshkrimi)
Data: _____

SHTOJCË NR. 3
FATURË PËR ARKËTIM

Nr. _____, datë_____

Bankës_____

Me anë të kësaj fature kërkojmë që banka juaj të pranoje nga klientë (individë) arkëtime të të ardhurave, për llogari të buxhetit të qeverisjes së përgjithshme, me emërtimet, kodin dhe shumat përkatëse, si më poshtë:

Kodi i llogarisë ekonomike ku do të derdhet tatimi nga rivlerësimi është _____
Emri institucionit: Drejtoria vendore e ASHK-së_____
Numri i llogarisë dhe IBAN për RVP: _____
Kodi i degës së thesarit:

Nr.	Përshkrimi i të ardhurave/emërtimi	Mënyra e përllogaritjes	Shuma që arkëtohet (lekë)	Nr. llogarisë së DVASHK-së për RVP-në
1	... Tatim nga rivlerësimi i pasurisë së individëve (3%) të bërë nga ASHK	3% e (vlerës së dalë nga rivlerësimi me çmimet minimale fiskale – (minus) vlerën e pasurisë së aktit të regjistruar/të rivlerësuar)		
2	... Tatim nga rivlerësimi i pasurisë së individëve (3%) të bërë nga eksperti vlerësues i licencuar	3% e (vlerës së dalë nga akti i ekspertimit, jo më pak se çmimet minimale fiskale –(minus) vlerën e pasurisë sipas aktit të regjistruar, /të rivlerësuar)		

DREJTORIA VENDORE E ASHK-së KLIENTI

Emër/mbiemër/firmë **Individ**_____
Emër/mbiemër

SHTOJCË NR. 4
FATURË PËR ARKËTIM

Nr. _____, datë_____

Bankës_____

Me anë të kësaj fature kërkojmë që banka juaj të pranojë nga klientë (persona juridike/individë) arkëtime të të ardhurave, për llogari të buxhetit të qeverisjes së përgjithshme, me emërtimet, kodin dhe shumat përkatëse, si më poshtë:

Kodi i llogarisë ekonomike ku do të derdhet tatimi nga rivlerësimi është _____
Emri institucionit përfitues (teknik): Rivlerësimi i pasurive të paluajtshme
Kodi i institucionit përfitues: Sipas kodeve përkatëse të çdo rrethi_____
Kodi i degës së thesarit: Sipas kodeve përkatëse të çdo rrethi._____

Nr.	Përshkrimi i të ardhurave/emërtimi	Kodi i llogarisë ekonomike	Shuma që arkëtohet (lekë)
1	... Tatim nga rivlerësimi i pasurisë së personave juridikë (5%)		

KLIENTI

Person juridik_____
NIPT/NUIS_____
Administratori/përfaqësuesi
_____
Emër/mbiemër/nënshkrimi
_____
Adresa:
Kontakti:

VENDIM
Nr. 123, datë 13.2.2020

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 594, DATË 31.8.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT 'VIJA BREGDETARE E QYTETIT TË VLORËS, FAZA 1, SHTESA, PJESA LINDORE', VLORË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 99/2018, "Për buxhetin e vitit 2019", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 594, datë 31.8.2016, të Këshillit të Ministrave, numri i pasurisë me numër rendor 4, në tabelën 2/A, "Shtesa në zonën I, Skelë - Shkolla e Marinës", ndryshon dhe bëhet 23/99+1-8.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Bashkia Vlorë dhe Agjencia Shtetërore e

Kadastrës, Drejtoria Vendore Vlorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 124, datë 13.2.2020

PËR KALIMIN NË PRONËSI NGA QENDRA E REALIZIMIT TË VEPRAVE TË ARTIT TE BASHKIA TIRANË, TË PASURISË NR. 4/239-N, ME EMËRTIMIN "QENDRA E REALIZIMIT TË VEPRAVE TË ARTIT", NË ZONËN KADASTRALE 8260

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, dhe të neneve 3, shkronja "d", 5, 7, 8 e 17, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi nga Qendra e Realizimit të Veprave të Artit te Bashkia Tiranë, të pasurisë nr. 4/239-N, me emërtimin "Qendra e Realizimit të Veprave të Artit", në zonën kadastrale 8260, me sipërfaqe 348 (treqind e dyzet e tetë) m^2, me adresë: Rruga "Muhamet Gjollesha", Tiranë, me qëllim përdorimin për kryerjen e veprimtarisë kulturore të Qendrës së Restaurimit dhe Realizimit të Veprave të Artit "Tirana", sipas genplanit e planimetrive, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Bashkisë Tiranë i ndalohet të ndryshojë destinacionin e pasurisë së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë atë apo t'ua japë në përdorim të tretëve.

3. Pasuria e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, i shtohet listës përfundimtare, të pjesshme, të pronave të paluajtshme publike shtetërore, miratuar me vendimin nr. 219, datë 21.3.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës përfundimtare të pjesshme (pjesa e parë + pjesa e dytë), të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Njësisë Administrative Tiranë, Bashkia Tiranë, të qarkut të Tiranës", të ndryshuar.

4. Ngarkohen Ministria e Kulturës, Bashkia Tiranë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama


FRAGMENT NGA PLANIMETRIA E TIRANËS, ZK. 8260, TR; S-9, VITI 2020, SH.1:500
Porositës: D.P.RR.P.P.K. MINISTRIA E KULTURËS
D.P.S.H.K.RR.
Nr. Prot. 1399, Datë: 13/01/2020
RRUGA "HIQMET DELVINA"
QENDRA REALIZIMIT TË VEPRAVE DE ARTIT
1K(Kapanon)
SHËNIME
GEN-PLANI SHOQËROHET GJITHMONË ME FRAGMENTIN E HARTËS NË SHKALLË 1:2000
PJESA ME VIJË TË NDËRPRERË DHE E RRJETZUAR ËSHTË PRONA E AZHORNUAR NË TERREN
REFERUAR VËRTETIMIT NGA DOKUMENTET HIPOTEKOR DHE HARTËS TREGUESE BASHKËLIDHUR SHKRESËS ME NR. PROT. 15,
DATË 06.01.2020, PROTOKOLLUAR NË BASHKINË E TIRANËS ME NR. PROT. 1399, DATË : 3 01.2020, TË MINISTRISË SË KULTURËS,
DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE DHE E PËRPUTHSHMËRISË PËR KULTURËN, DREJTORIA E PROGRAMIMIT
STANDARTIZIMIT DHE HARMONIZIMIT TË KUADRIT RREGULLATOR, SI DHE REFERUAR KARTELËS SË PASURISË DHE HARTËS
TREGUESE BASHKËLIDHUR SHKRESËS ME NR. PROT. 1399/1, DATË 17.01.2020, TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME JURIDIKE E
ASETEVE DHE E LIÇENSIMIT, DREJTORIA E PASURIVE TË PALUAJTSEME, SIPËRFAQJA E KËRKUAR PËR AZHORNIM ËSHTË
PASURIA "NDËRTESË" ME NR. 4/239/ND, ZK. 9260, ËSHTË PASURIA "NDËRTESË" ME NR. 4/239/ND, ZK. 9260,
INDEKS HARTE TR. S-9, VOL. 41, FQ. 50, ME GJENDJEN JURIDIKE "QENDËR REALIZIMI ARTIT TË VEPRAVE TË KULTURES"
SIP. 252.32 M2-PRONA REFERUAR HARTËS TREGUESE TË REGJISTRIMIT
SIP. 362.55 M2-PRONA REFERUAR GJENDJES FAKTIKE NË TERREN
REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA E TIRANËS
DREJTOR I KADASTRËS
ENDRIT SHTJEFNI
DREJTORIA E KADASTRËS
PËRGJ. SEKTORIT TË KADASTRËS URBANE
MERITA QIRIAKO
Date 22/01/2020
AZHORNOI
HASAN KORBI

SH. 1:2000
RRUGA "SULEIMAN DELVINA"
RRUGA "SULEIMAN DELVINA"
RRUGA "OSMAN MAZREJTI"
RRUGA "MEDAR SHYTLA"
RRUGA "SKENDER LUARASI"
RRUGA "HILMI GOLEMI"
RRUGA "LIMAN KABA"

PLANIMETRI DIMENSIONIMI
KATI PARE SH 1-100



PLANIMETRI DIMENSIONIMI
KATI DYTE SH 1-100



VENDIM
Nr. 125, datë 13.2.2020

PËR EMËRIMIN NË DETYRË TË DREJTORIT TË QENDRËS KOMBËTARE TË KULTURËS PËR FËMIJË DHE TEATRIT TË KUKULLAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 1 e 3, të nenit 9, të ligjit nr. 10352, datë 18.11.2010, "Për artin dhe kulturën", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Agim Bajko emërohet drejtor i Qendrës Kombëtare të Kulturës për Fëmijë dhe Teatrit të Kukullave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 127, datë 13.2.2020

PËR KRITERET E RREGULLAT DHE PËR LEJIMIN E VEPRIMTARISË PËR MBLEDHJEN, AKSESIN E PËRDORIMIN E MATERIALEVE DHE TË MOSTRAVE NGA MJEDISET E ZONAVE TË MBROJTURA MJEDISORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 65, të ligjit nr. 81/2017, "Për zonat e mbrojtura", me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e kritereve dhe të rregullave për lejimin e veprimtarisë për mbledhjen, aksesin e përdorimin e materialeve dhe të mostrave nga mjediset e zonave të mbrojtura mjedisore.

2. Mbledhja, aksesi dhe përdorimi i materialeve biologjike dhe e mostrave nga mjediset e zonave të mbrojtura mjedisore në vegjetacione bimë, alga, myshqe dhe pjesë të tyre, në kafshë vertebrore dhe jovertebrore, në materiale mikrobike, baktere, virus dhe në kërpudha, në sasi të konsiderueshme, kryhet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi për zonat e mbrojtura dhe biodiversitetin.

3. Veprimtaria e mbledhjes dhe e përdorimit të materialeve a të mostrave nga mjediset e zonave të mbrojtura mjedisore kryhet pas miratimit të saj.

4. Të drejtën për mbledhjen dhe përdorimin e materialeve a të mostrave biologjike nga mjediset e zonave të mbrojtura e kanë institucionet kërkimore-shkencore, publike apo private, si: institucionet e arsimit të lartë, institucionet e qendrat ndërinstitucionale të kërkim-zhvillimit, institutet e kërkim-zhvillimit pranë ministrive, si dhe institucionet e tjera të interesuara, organizata jofitimprurëse të specializuara të kësaj fushe, studiues, studentë, vendës apo të huaj.

5. Subjektet e parashikuara në pikën 4, të këtij vendimi, paraqesin kërkesën për mbledhjen e përdorimin e materialeve a të mostrave biologjike nga mjediset e zonave të mbrojtura pranë Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (në vijim, AKZM). Subjektet dorëzojnë kërkesën me shkrim pranë AKZM-së të paktën 3 (tre) muaj para fillimit të veprimtarisë së planifikuar.

Kërkesa duhet të përmbajë:

a) emrin e mbiemrin e aplikantit;

b) adresën e aplikantit;

c) informacionin për veprimtarinë e kryer nga subjekti që ka paraqitur kërkesën;

ç) listën e anëtarëve të stafit që do të marrin pjesë në veprimtarinë e aksesit, të mbledhjes e të përdorimit të materialeve biologjike ose të mostrave;

d) fushën e veprimtarisë dhe qëllimin e aksesit, të mbledhjes e të përdorimit të materialeve biologjike ose të mostrave;

dh) materialin biologjik që do të jetë objekt i veprimtarisë së aksesit, mbledhjes dhe të përdorimit, numrin e mostrave dhe sasitë përkatëse (që duhet të jenë në masën më minimale të nevojshme);

e) vendin dhe kohën e kryerjes së veprimtarisë;

ë) kushtet e ruajtjes e të transportit të materialeve biologjike ose të mostrave; dhe

f) deklaratën se veprimtaria nuk do të ketë ndikime negative në drejtim të erozionit gjenetik/humbjes.

6. Kërkesa me shkrim shoqërohet me informacionin e nevojshëm, sipas shtojcave 1, 2 e 3, dhe formularin e vetëdeklarimit, sipas shtojcës 4, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

7. AKZM-ja, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e dorëzimit, shqyrton kërkesën dhe dokumentacionin e paraqitur në bazë të kritereve të mëposhtme:

a) veprimtaria kërkimore të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi për ruajtjen e mbrojtjen e natyrës dhe të planeve të menaxhimit;

b) metodika e kampionimit të mos ndikojë në konservimin dhe në biologjinë e llojit;

c) veprimtaria kërkimore të mos ketë ndikim negativ në diversitetin biologjik;

ç) të jetë marrë miratimi paraprak për aksesin e përdorimin e materialit biologjik ndërmjet pronarit, kur toka është pronë private, dhe subjekteve/individëve, të përcaktuar në pikën 4, të këtij vendimi;

d) të jetë rënë dakord për kushtet e përdorimit të mëvonshëm të materialeve dhe ndarjen e përfitimeve, monetare dhe jomonetare, në Republikën e Shqipërisë.

8. Kur kërkesa për mbledhjen dhe përdorimin e materialeve a të mostrave biologjike nga mjediset e zonave të mbrojtura paraqitet nga organizata jofitimprurëse e specializuar e kësaj fushe, studiues, studentë, vendës apo të huaj, veprimtaria përmban edhe këto kushte:

a) ndarjen ose përdorimin e mëvonshëm të materialeve kërkimore ndërmjet studiuesve, vendës e të huaj, duke u mbështetur në kushtet e vendosura paraprakisht në marrëveshje dhe në bazë të rezultateve përfundimtare;

b) të drejtën që Republika e Shqipërisë t'i shfrytëzojë a t'i përdorë kampionet ose produktin e arritur, si dhe të dhënat e mbledhura nëpërmjet këtyre veprimtarive;

c) vlerësimin e të dhënave për zyrtarizimin e tyre;

ç) pëlqimin e dhënë nga ministri, që të dhënat e rezultateve të kërkimeve të pasqyrohen në rrjetet ndërkombëtare të informacionit.

9. Në rast se AKZM-ja konstaton se kërkesa e paraqitur nga subjektet kërkuese, të parashikuara në pikën 4, të këtij vendimi, nuk plotëson kushtet/kriteret e përcaktuara në këtë vendim, Agjencia njofton subjektet për të bërë plotësimet e nevojshme brenda një afati 10-ditor (dhjetëditor).

10. AKZM-ja, pas plotësimit të dokumentacionit, shqyrton kërkesën brenda afatit të parashikuar në pikën 7, të këtij vendimi dhe, në përputhje me kushtet/kriteret e këtij vendimi, brenda 7 (shtatë) ditëve, nxjerr aktin e miratimit ose të refuzimit për veprimtarinë.

11. Materialet e mbledhura si pjesë e veprimtarive kërkimore mbeten pronë e Republikës së Shqipërisë ose e pronarit nga i cili janë mbledhur fillimisht dhe kthehen me përfundimin e veprimtarisë kërkimore, nëse nuk është rënë dakord ndryshe, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi për mbrojtjen e mjedisit.

12. Personeli i zonës së mbrojtur mjedisore, për të gjitha rastet e kryerjes së veprimtarisë së mbledhjes së materialeve dhe të mostrave nga mjediset e zonave të mbrojtura mjedisore, shoqëron subjektet fizike e juridike, vendës e të huaj, gjatë kryerjes së veprimtarisë prej tyre. Në rastet kur këto subjekte nuk njoftojnë Administratën e Zonave të Mbrojtura (në vijim, AdZM), ato nuk lejohen të kryejnë veprimtarinë dhe AdZM-ja njofton AKZM-në për marrjen e masave të nevojshme, deri në propozimin për shfuqizimin e miratimit të veprimtarisë.

13. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

SHTOJCË NR. 1
DETAJE TË PËRGJITHSHME PËR APLIKIMIN
PËR TË DREJTËN E USHTRIMIT TË VEPRIMTARIVE PËR MIRATIMIN E VEPRIMTARISË PËR MBLEDHJEN, AKSESIN E PËRDORIMIN E MATERIALEVE DHE TË MOSTRAVE NGA MJEDISET E ZONAVE TË MBROJTURA MJEDISORE

Ky formular do të përdoret për mbledhjen dhe përdorimin e materialeve biologjike dhe mostrave, të cilat do të kryhen brenda zonave të mbrojtura

1.1 Emër, mbiemër:			
1.2 Institucioni:			
1.2.1 Titulli:			
1.3 Adresa:			
1.3.1 Kodi postar:			
1.4 Nr. i telefonit:		*e-mail*:	NUIS

1.5. Titulli i studimit/projektit:

1.6. Koordinatat gjeografike të zonës:

1.7 Përshkrimi i shkurtër i projektit:

1.8 Qëllimi i aksesit, i mbledhjes dhe i përdorimit të materialeve biologjike ose mostrave:

1.9 Metodologjia e studimit/projektit:

1.2.0 Fillimi dhe mbarimi i projektit:

SHTOJCË NR. 2
DETAJE PËR VEPRIMTARINË

2.1 Emri i zonës së mbrojtur:

2.2 Qarku:

2.3 Emri latinisht i llojit:

Vegjetacion

Bimë

Alga

Myshk

Pjesë të tyre

Kafshë

Vertebrorë

Jovertebrorë

Mikrobik

Bakterie

Virus

Kërpudha

2.4 Emri i zakonshëm i llojit:

Statusi i llojit

I rrezikuar □
I përkeqësuar □
I kërcënuar □
Sasia □
Shpeshtësia □

SHTOJCË NR. 3

3.1 Transferimi i materialit nga burimet *in situ* në *ex situ*

Banka gjenetike □
Kopshte/parqe zoologjike □
Kopshte botanike □
Akuarium □
Laboratorë të specializuar të bioteknologjisë □

SHTOJCË NR. 4
VETËDEKLARIM

Unë i/e nënshkruari _____, i datëlindjes _____.
(emër, atësi, mbiemër) (datë/muaj/vit)

Nëse aplikanti përfaqëson një institucion, duhet të saktësojë pozicionin që mban
_____

deklaroj me vullnet të lirë e të plotë se mbaj përgjegjësi personale për të gjithë informacionin që është plotësuar në këtë formular dhe se veprimtaria e kërkimit shkencor nuk do të ketë ndikime negative në drejtim të prishjes së ekuilibrave natyrorë dhe se, mbas përfundimit të projektit, do të dorëzoj pranë ministrisë përgjegjëse për mjedisin dhe Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura rezultatet e arritura gjatë kryerjes së kësaj veprimtarie.

Deklaruesi
_____
Firma

Datë
____. ___.___

UDHËZIM I PËRBASHKËT
Nr. 1, datë 15.1.2020

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN E PËRBASHKËT NR. 33, DATË 29.12.2014, "PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË SHËRBIMIT PËR VEPRIME E SHËRBIME TË ADMINISTRATËS GJYQËSORE TË MINISTRISË SË DREJTËSISË, PROKURORISË DHE NOTERISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të nenit 11, të ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008, "Për taksat kombëtare", të ndryshuar, ministri i Drejtësisë dhe ministri i Financave dhe Ekonomisë,

UDHËZOJNË:

Në udhëzimin e përbashkët, nr. 33, datë 29.12.2014, "Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për veprime e shërbime të administratës gjyqësore të Ministrisë së Drejtësisë, Prokurorisë dhe Noterisë", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Në shtojcën nr. 1, pika 3 shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Etilda Gjonaj

MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË
Anila Denaj

UDHËZIM I PËRBASHKËT
Nr. 2, datë 22.1.2020

PËR NJË NDRYSHIM NË "UDHËZIMIN E PËRBASHKËT NR. 1276/5, DATË 27.7.2017, 'PËR CAKTIMIN E TARIFAVE PËR SHËRBIMET E OFRUARA NGA SHËRBIMI PËRMBARIMOR GJYQËSOR SHTETËROR'", I NDRYSHUAR, TË MINISTRIT TË DREJTËSISË DHE MINISTRIT TË FINANCAVE DHE EKONOMISË

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, si dhe neneve 12 dhe 12/a, të ligjit nr. 8730, datë 18.1.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror", i ndryshuar, ministri i Drejtësisë dhe ministri i Financave dhe Ekonomisë,

UDHËZOJNË:

Në udhëzimin e përbashkët nr. 1276/5, datë 27.7.2017, "Për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror", i ndryshuar, me udhëzimin nr. 32, datë 30.8.2018, bëhet ndryshimi si më poshtë:

1. Në seksionin V, pika 3, germa "c", shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Etilda Gjonaj

MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 18, datë 17.1.2020

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË URDHRIN NR. 267, DATË 24.7.2019, "MBI MIRATIMIN E RREGULLORES PËR MËNYRËN, KRITERET DHE PROCEDURAT E KATEGORIZIMIT TË STRUKTURAVE AKOMODUESE", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 3 të nenit 4, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 730, datë 20.10.2016, "Për miratimin e rregullores për kushtet, kriteret, tarifat, afatet dhe procedurën për klasifikimin e strukturave akomoduese", i ndryshuar,

URDHËROJ:

Në tekstin e rregullores së miratuar me urdhrin nr. 267, datë 24.7.2019, "Mbi miratimin e rregullores për mënyrën, kriteret dhe procedurat e kategorizimit të strukturave akomoduese", të ndryshuar, bëhen shtesa dhe ndryshime si me poshtë vijon:

1. Pika 1, e nenit 6, ndryshon si më poshtë:

"1. Dokumentacioni që duhet të paraqesë subjekti:

1.1 Dokumentacioni i detyrueshëm:

a) kërkesë për t'u pajisur me certifikatë kategorizimi sipas modelit, shtojca 2, bashkëlidhur kësaj rregulloreje;

b) formularin e vetdeklarimit, sipas modelit, shtojca 3, bashkëngjitur kësaj rregulloreje;

c) vërtetim për regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit si person fizik/juridik me objekt veprimtarie si strukturë akomoduese;

d) vërtetim i gjendjes gjyqësore të pronarit/administratorit.

1.2 Dokumentacioni shoqërues:

a) akti i pronësisë ose përdorimit të strukturës;

b) planimetrinë e strukturës akomoduese;

c) vërtetimin që struktura plotëson kushtet për masat e mbrojtjes nga zjarri lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi;

d) vërtetimin që struktura plotëson kushtet higjeno-sanitare, lëshuar nga Instituti i Shëndetit Publik;

e) foto të brendshme dhe të jashtme të objektit.

2. Pas pikës 2, të nenit 6, shtohen pikat 3 dhe 4, me përmbajtje si vijon:

"3. Dokumentacioni i germave "c" dhe "d", të pikës 1.1, në rast se nuk paraqitet nga subjekti do të sigurohet, nëpërmjet portalit e-albania nga ministria përgjegjëse për turizmin.

"4. Dokumentacioni shoqërues, në rast se nuk është depozituar nga subjekti në momentin e aplikimit, duhet të dorëzohet brenda datës 31.12.2020, pranë ministrisë përgjegjëse për turizmin.".

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT
Blendi Klosi

URDHËR
Nr. 96, datë 10.2.2020

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje dhe zbatim të nenit 11/b, të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003, "Për arkivat"; të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe të nenit 11, pikave 2 dhe 3, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore",

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Drejtorisë të Përgjithshëm të Arkivave, z. Endrit Musaj, drejtor i Inspektimit dhe i Trajnimeve, për shkak të mungesës me arsye të titullarit të këtij institucioni.

2. Kompetencat e Drejtorit të Përgjithshëm të Arkivave do të ushtrohen për periudhën nga data 12.2.2020 deri në datën 21.2.2020.

3. Nuk delegohen kompetencat e drejtuesit lidhur me personelin, si dhe kompetencat e tjera të padelegueshme, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

4. Për veprimet e kryera në zbatim të këtij urdhri, drejtori i Inspektimit dhe i Trajnimeve do të ruajë kopje të kartelave shoqëruese të praktikave shkresore të iniciuara apo të përfunduara prej tij, së bashku me afatet e përcaktuara dhe ecurinë e mbarëvajtjen e çështjeve, dhe do t'ia bëjë të ditura titullarit me rikthimin e tij në detyrë.

5. Për zbatimin e

urdhrit ngarkohet drejtori i Inspektimit dhe i Trajnimeve, z. Endrit Musaj.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ardit Bido

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 280 lekë